



LETËRNJOFTIMI I KOMUNAVE

Vushtrri

2021

Letërnjoftimi i Komunave Vushtrri

Shtator 2021

— Përmbajtja

Fakte kryesore	4
Popullsia	4
Zgjedhjet	5
Diaspora	5
Territori	6
Përfaqësimi politik	7
Buxheti	8
Mirëqenia Sociale dhe Shëndetësia	12
Skema e ndihmës sociale	12
Shëndetësia	13
Arsimi	14
Administrata komunale	17
Transparenca	19
Transparenca buxhetore	19
Transparenca komunale	20
Konkurueshmëria e komunave	21
Ekonomia lokale	22
Shërbimet publike	24
Qasja në ujësjellës	24
Menaxhimi i mbeturinave	26

Përmbledhje


- Komuna e Vushtrrisë ka **62,026 banorë**, një rënie prej **11%** që nga regjistrimi i popullsisë më 2011.
- Komuna e Vushtrrisë në listat e votuesve ka **67,656 persona**, apo më shumë votues se popullsia.
- Vushtrria radhitet **e shtata** si komuna me numrin më të madh të diasporës.
- Vushtrria është një ndër komunat me **densitet mesatar të popullsisë** (180 banorë për kilometër katror).
- **Buxheti** i planifikuar i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021 është **18.9 milionë euro**.
- Sa i përket kategorisë së shpenzimeve, pjesa më e madhe e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë shpenzohet për **paga dhe mëditje (57%)**.
- **22%** e buxhetit ndahet për **investime kapitale**.
- **10%** e banorëve të Vushtrrisë janë në **skemën e ndihmës sociale**.
- Numri i nxënësve në shkollat e Vushtrrisë ka pësuar **rënie** përgjatë viteve. Në vitin shkollor 2018/2019 ka **23%** më pak nxënës se sa në vitin shkollor 2008/2009.
- Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët Komuna e Vushtrrisë **sa i përket relacionit nxënës-mësimdhënës** ka raport 17.30, apo një mësimdhënës për 17 nxënës.
- Në administratën komunale të Vushtrrisë janë të punësuar **216 shërbyesë civil**, apo një shërbyes për 287 banorë.
- Nga numri i përgjithshëm i të punësuarëve në shërbimin civil në Vushtrri, **vetëm 28% e shërbyesve civil janë gra**. Vushtrria bën pjesë në mesin e komunave me pjesëmarrjen më të ulët të grave në shërbimin civil komunal.
- Nga 67 lokalitete në Komunën e Vushtrrisë, Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidro Regjioni Jugor" menaxhon **ujësjellësin në 33 vendbanime**.
- Në Komunën e Vushtrrisë, **93% të vendbanimeve marrin shërbimin e grumbullimit të mbeturinave**.
- Në Komunën e Vushtrrisë janë aktive **2,373 biznese**.
- Në sektorin privat në Komunën e Vushtrrisë **janë të punësuar 5,808 persona**, kurse në sektorin publik 1,304 persona.
- Nga Komuna e Vushtrrisë janë **10,949 kontributpagues** në Trustin e Kursimeve Pensionale.

Fakte kryesore

Popullsia


Sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) del se më 31 dhjetor 2019, Komuna e Vushtrrisë kishte 62,026 banorë. Nga regjistrimi i popullsisë më 2011, e deri në vlerësimin e fundit të popullsisë më 2019, Vushtria ka shënuar rënie të popullsisë prej 11%.

Fig. 1 Popullsia e Komunës së Vushtrrisë



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK dhe OSBE

Fig. 2 Trendet e popullsisë në komuna 2011-2019




Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK dhe OSBE

Zgjedhjet

Në zgjedhjet parlamentare që u mbajtën më 14 shkurt 2021, në listën e votuesve nga Komuna e Vushtrisë ishin 67,656 persona. Vlerësuar nga numri i daljes për të votuar, që nga zgjedhjet e para lokale të vitit 2000, numri më i madh është shënuar në zgjedhjet e fundit lokale të 2017 ku të drejten e votës e kanë ushtruar rreth 71,978 persona, apo 43.47%.

Fig. 3 Trendi i votuesve të regjistruar dhe dalja në zgjedhjet për kuvend komunal




Burimi: GAP, bazuar në statistikat e KQZ, të dhënat për 2021 janë për zgjedhjet parlamentare

Diaspora

Një nga arsyt përse Vushtrria ka më shumë votues se sa popullsia me banim të përhershëm është për shkak të diasporës. Sipas Rezultateve Preliminare të Regjistrimit të Diasporës¹, nga 400,000 pjesëtarët e diasporës së regjistruar, 19,120 persona kanë lindur në Komunën e Vushtrisë.

Duke marr parasysh numrin e popullsisë më 2019 dhe të dhënat e diasporës për vitin 2017 del se Komuna e Vushtrisë ka një shkallë të lartë të diasporës dhe renditet e shtata sipas komunave.

Fig. 4 Diaspora si përqindje e popullsisë




Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës

¹ Regjistrimi i Diasporës nga Ministria e Diasporës (tash Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës) më 2017.

Territori


Komuna e Vushtrrisë ka territor prej 344 km². Përbëhet prej qytezës së Vushtrrisë si qendër urbane dhe 67 fshatrave.

Fig.5 Territori në km²



Densiteti i popullsisë në Komunën e Vushtrrisë është 180 banorë për kilometër katror.


Fig.6 Densiteti (populli për km²)



Përfaqësimi politik

Në pesë palë zgjedhjet lokale për kuvend komunal, partitë politike që kanë marrë pjesë vazhdimisht në zgjedhje janë LDK, PDK, AAK. Në zgjedhjet e fundit për kuvendin komunal partia me përqindjen më të madhe të votave është PDK (31%), pas saj renditen LDK (18%), LVV (20%) dhe AAK (8%).

Fig. 7 Zgjedhjet për Kuvend Komunal (2000–2017)



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e KQZ, *Në zgjedhjet lokale të 2013, AAK dhe LDD kanë qenë në koalicion parazgjedhor.


Postin e kryetarit të komunës nga viti 2000 e kanë mbajtur tre persona, nga dy parti politike.

Tab. 1 Kryetarët e Komunës së Vushtrrisë nga viti 2000.

Vitet	Kryetari/ja
2000 – 2002	Muharrem Shabani (LDK)
2002 – 2007	Muharrem Shabani (LDK)
2007 – 2009	Bajram Mulaku (PDK)
2009 – 2013	Bajram Mulaku (PDK)
2013 – 2017	Bajram Mulaku (PDK)
2017 – 2021	Xhafer Tahiri (LDK)

Buxheti i planifikuar i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021 është 18.9 milionë euro.


Fig. 8 Buxheti vjetor 2013–2021 (në euro)



Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve


Në karahasim me komunat tjera, për nga buxheti, Komuna e Vushtrrisë radhitet e nënta.

Fig. 9 Planifikimi i buxhetit sipas komunave 2021 (në euro)



Në bazë të kategorisë së të hyrave, deri në vitin 2020 është vërejtur një rritje e transfereve qeveritare nga niveli qendror dhe rënie e të hyrave vetanake (të planifikuara).


Fig. 10 Planifikimi i të hyrave (në euro)



Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve

E hyra kryesore komunale është tatimi në pronë, e cila ka shënuar rritje viteve të fundit, pas së cilës vijnë taksat për mbeturina, certifikatat dhe lejet për ndërtesa.


Fig. 11 Të hyrat vetanake



Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve

Sa i përket kategorisë së shpenzimeve, pjesa më e madhe e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë shpenzohet për paga dhe mëditje (57%).


Fig. 12 Buxheti i planifikuar i komunës së Vushtrrisë sipas kategorive ekonomike (2021)



Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve

Komuna e Vushtrrisë shpenzon mbi gjysmën e buxhetit komunal për paga dhe mëditje.


Fig. 13 Shpenzimet e planifikuara për paga dhe mëditje (2021)



Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve

Sa i përket kategorisë së shpenzimeve kapitale, 22% e buxhetit ndahet për investime kapitale.

Fig. 14 Shpenzimet Kapitale (të realizuara)




Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve

Mirëqenia Sociale dhe Shëndetësia

Skema e ndihmës sociale

Në mars të vitit 2021 ishin 6,453 anëtarë të familjeve nga Komuna e Vushtrrisë në skemën e ndihmës sociale. Nëse e krahasojmë me të dhënat e vlerësimit të popullsisë në fund të vitit 2019, del se 10% e banorëve të Vushtrrisë janë në skemën e ndihmës sociale.


Fig. 15 Popullsia në skemën e ndihmës sociale (mars 2021) kundrejt numrit total të popullsisë (vlerësimi 2019)



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK për mirëqenien sociale dhe vlerësimin e popullsisë për 2019

Popullsia në ndihmë sociale në Vushtrri ka pasur rritje në mars të vitit 2021.

Fig. 16 Përfituesit e ndihmave sociale në Vushtrri (2016–2021) sipas anëtarëve të familjes




Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK për mirëqenien sociale

Shëndetësia

Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri janë të angazhuar gjithsej 207 punëtorë shëndetësorë.

Sa i përket relacionit mes kuadrit shëndetësor dhe popullsisë, Komuna e Vushtrrisë është në mesin e atyre komunave ku relacioni është mesatarisht i lartë.


Fig. 17 Kuader shëndetësor për popullsi



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK për vlerësimin e popullsisë dhe të dhënat e MFT për numrin e të punësuarve sipas organizatave buxhetore

Në Komunën e Vushtrrisë mësimin e ndjekin 13,674 nxënës në të gjitha nivelet e arsimit para univesitar. Numri i nxënësve në shkollat e Vushtrrisë ka pasur rënie përgjatë viteve, ku në vitin shkollor 2018/2019 ka 23% më pak nxënës se sa në vitin shkollor 2008/2009.


Fig. 18 Numri i nxënësve nga viti shkollor 2008/09 deri 2019/20



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASH

Në krahasim me komunat tjera, Komuna e Vushtrrisë për nga rënia e nxënësve radhitet e 22-ta.


Fig. 19 Trendi i numrit të nxënësve 2008/09–2019–20



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASH

Sa i përket personelit nëpër shkolla, Komuna e Vushtrrisë ka të punësuar 842 mësimdhënës, 135 persona ndihmës dhe 75 administrativ.


Fig. 20 Mësimdhënës, personel ndihmës dhe administrativ në shkollat e Vushtrrisë



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASH

Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, Komuna e Vushtrrisë e ka raportin mësimdhënës – nxënës 17.30, apo një mësimdhënës për 17 nxënës.

Fig. 21 Raporti mësimdhënës-nxënës në nivelin parafillor, fillor dhe mesëm i ulët




Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASH

Administrata komunale

Në administratën komunale të Vushtrrisë janë të punësuar 216 shërbyesë civil, apo një shërbyes për 287 banorë.


Fig. 22 Shërbyes civil për popullatë



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK për vlerësimin e popullsisë dhe të dhënat e MPB për numrin e shërbyesve civil sipas organizatave buxhetore

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarëve në shërbimin civil në Vushtrri, vetëm 28% e shërbyesve civil janë gra. Vushtrria bën pjesë në mesin e komunave me pjesëmarrje të ulët të grave në shërbimin civil komunal.


Fig. 23 Përqindja e grave në shërbimin civil



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e MPB për numrin e shërbyesve civil sipas organizatave buxhetore

Komuna e Vushtrrisë bën pjesë në mesin e komunave me pjesëmarrje të ulët të grave në pozita udhëheqëse. Vetëm 18% e grave janë në pozita udhëheqëse.


Fig. 24 Përqindja e grave në pozita udhëheqëse në shërbimin civil



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e MPB për numrin e shërbyesve civil sipas organizatave buxhetore

Mosha mesatare në shërbimin civil të Komunës së Vushtrrisë është 49 vjeç.

Fig. 25 Mosha mesatare në shërbimin civil




Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e MPB për numrin e shërbyesve civil sipas organizatave buxhetore

Transparenca

Transparenca buxhetore

Në vlerësimin e fundit të Institutit GAP për transparencën buxhetore të komunave për vitin 2018, Komuna e Vushtrisë radhitet në vendin e 12-të, dhe është vlerësuar me 69.5 pikë nga 100 të mundshmet.

Fig. 26 Indeksi për transparencë buxhetore komunale 2018



Burimi: GAP, Indeksi i Transparencës Buxhetore 2018

Transparenca komunale

Në indeksin e vlerësimit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI)² për transparencën në komuna për vitin 2020, Komuna e Vushtrrisë radhitet në vendin e katërt nga 38 komuna.

Në 6 shtyllat e vlerësimit të KDI, Komuna e Vushtrrisë ka marr këtë vlerësim:

Tab. 2 Transparenca Komunale (2020)

	Pikët maksimale	Vushtrria
I	30	28.5
Prokurimi publik (duke përfshirë ankandet publike)		
II	25	21.88
Transparenca buxhetore		
III	10	10
Qasja në dokumente publike		
IV	15	15
Informimi dhe pjesëmarrja e publikut		
V	10	7.5
Grantet dhe financimi		
VI	10	10
Etika profesionale dhe konflikti i interesit		

² KDI. Indeksi i Transparencës për qeverisjen komunale 2020. Prill 2021. Burimi: <https://bit.ly/3cIC8mz>

Konkurueshmëria e komunave

Për çdo vit, Instituti Riinvest vlerëson komunat sa i përket konkurrueshmërisë dhe shkallën në të cilën ato arrijnë të krijojnë një mjedis afarist të favorshëm. Indeksi bëhet duke vlerësuar barrierat e hyrjes në treg, transparencën e informatave publike, pjesëmarrja dhe konsultimi i biznesve në vendimmarrje, kostot kohore, taksat dhe tarifat, aftësia e administratës komunale, fuqia punëtore dhe shërbimet mbështetëse për biznese, si dhe infrastruktura lokale.

Nga 38 komuna, Vushtrria radhitet e 12-ta. Vlerësimi sipas nën-indeksëve duket kështu.³

Tab. 3 Indeksi i konkurrueshmërisë së komunave 2020


	Pikët maksimale	Vushtrria
Barrierat e hyrjes në biznes	10	8.09
Transparenca	10	6.84
Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria	10	6.01
Kostoja kohore	10	7.98
Taksat dhe tarifat	10	5.9
Aftësia e administratës lokale	10	4.38
Fuqia punëtore dhe shërbimet mbështetëse për biznese	10	4.49
Infrastruktura lokale	10	8.52

³ Riinvest. Indeksi i konkurrueshmërisë së komunave 2020. Burimi: <https://bit.ly/3x6jg2N>

Ekonomia lokale

Në korrik të vitit 2021, në Komunën e Vushtrrisë janë aktive 2,880 biznese. Përkundër pandemisë, numri i bizneseve në këtë komunë ka shkuar duke u rritur. Në sektorin privat në Komunën e Vushtrrisë janë të punësuar 5,164 persona.


Fig. 27 Bizneset aktive në Komunën e Vushtrrisë dhe numri të punësuarve



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ATK të siguruar sipas kërkesës për qasje në informata zyrtare

Që nga viti 2013 numri i bizneseve të reja është shumë më i madh se numri i bizneseve të shuara.


Fig. 28 Numri i bizneseve të reja dhe të shuara



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK


Përveç 5,164 të punësuarve në sektorin privat në territorin e Komunës së Vushtrrisë, në sektorin publik në këtë komunë janë të punësuar edhe 1,606 persona.

Fig. 29 Numri i të punësuarve në sektorin publik dhe privat në komunën e Vushtrrisë



Në anën tjetër, numri i kontributpaguesve aktiv nga Vushtrria në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trust) është më i madh. Kjo tregon se pjesa më e madhe e të punësuarve nga Komuna e Vushtrrisë janë të punësuar në biznese apo institucione publike jashtë territorit të komunës.

Fig. 30 Kontribues në trust




Shërbimet publike

Qasja ne ujësjellës

Nga 67 lokalitete në Komunën e Vushtrrisë, Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" menaxhon ujësjellësin në 33 vendbanime. Ndërsa, projekti i ndërtimit të ujësjellësit në bashkëpunim me qeverinë zvicrrane në fshatrat Bequk, Strofc, Zhilivodë dhe Sllatinë është në perfundim e sipër. Sipas KRU "Mitrovica" numri i konsumatorëve të faturuar për ujësjellës për vitin 2020 ishte 13,353 konsumatorë⁴.

Në raportin e MAPL-së për vlerësimin e performancës komunale për vitin 2019, Komuna e Vushtrrisë ka raportuar për shtrirje të rrjetit të ujit të pijshëm në 85.34 % te ekonomitë familjare, institucionet publike dhe biznese⁵.

Fig. 31 Përqindja e qasjes së vendbanimeve në rrjetin e ujësjellësit (2019)




⁴ Të dhënat e pranura nga KRU "Mitrovica", datë 23.06.2021

⁵ Raporti i performancës së komunave – JANAR-DHJETOR 2019, Burimi: <https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/>

Në raportin e MAPL-së për vlerësimin e performancës komunale për vitin 2019, Komuna e Vushtrrisë ka raportuar 48.57% e vendbanimeve kanë qasje në rrjet të kanalizimit.

Fig. 32 Përqindja e qasjes së vendbanimeve në rrjetin e kanalizimit




Menaxhimi i mbeturinave

Në komunën e Vushtrisë, Kompania KRU "Uniteti" ofron shërbimin e grumbullimit të mbeturinave për ekonomitë familjare (amvisëritë) dhe për institucionet e bizneset e komunës. Shërbimi ofrohet për 15,870 ekonomi familjare rezidente apo jorezidente (përfshirë mërgimtarë), për 1,205 biznese aktive dhe joaktive dhe 164 institucione në komunë⁶.

Në raportin e MAPL-së për vlerësimin e performancës komunale për vitin 2019, Komuna e Vushtrisë ka raportuar se 93.46 % e vendbanimeve kanë qasje në rrjetin e menaxhimit të mbeturinave⁷.

Fig. 33 Përqindja e vendbanimeve të cilat mbulohen nga kompanitë për menaxhim të mbeturinave



⁶ Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave – Komuna e Vushtrisë 2021–2026, Burimi: <https://bit.ly/3xkCwck>

⁷ Raporti i performancës së komunave – Janar-Dhjetor 2019, Burimi: <https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/>

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtine

+381 38 609 339

info@institutigap.org

Instituti GAP përkrahet nga:



Ky projekt mbështetet nga:



